



Republika Kosova-Republika e Kosovës-Republic of Kosovo

Opština štrpce

Komuna e Shtërpçës

Municipality of Strpce



Në mbështetje të nenit 12, 17, 40 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, të neneve 10 dhe 34 të Statutit të Komunës së Shtërpçës Nr. 01- 898 të datës 14/07/2010, Kuvendi i Komunës së Shtërpçës në mbledhjen e mbajtur më datën 26/12/2018 miratoi këtë :

V E N D I M

Miraton procesverbal nga seanca e kuvendit e mbajtur me 30.11.2018

1. Miratohet procesverbal nga seanca e kaluar e Kuvendit i Komunës sipas tekstit e dhënë në këtë vendim.
2. Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e Kryesuesit të Kuvendit Komunal .

Kryesuesi i Kuvendit

Predrag Grbic





REPUBLIKA KOSOVO-REPUBLIKA E KOSOVËS
OPŠTINA ŠTRPCE-KOMUNA E SHTËRPCËS

IZLAZNI - DALËSE

Prot. Nr. 01-020/08-16798/18

Str. 6

Datum Data 28.12.2018

ŠTRPCE - SHTËRPCË



Republika Kosova-Republika e Kosovës-Republic of Kosovo
Opština Štrpce
Komuna e Shtërpçës
Municipality of Strpce

PROCESVERBAL

Nga seanca e dhjetë të rregullt e KK-ës të mbajtur më 30.11.2018, me fillim në ora 10:00

Rendi i ditës:

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i rendit të ditës
2. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KK-së
3. Shqyrtimi dhe aprovimi i Rregullores mbi tatim në pronë për vitin 2019
4. Formimi i komisionit për hartimin e Planit të punës së Kuvendit
5. Shqyrtimi dhe aprovimi i draft të Rregullores për organizimin e punës në arsim parauniversitar në komunën e Shtërpçës.
6. Të ndryshme.

1. Shqyrtimi dhe miratimi i rendit të ditës

Predrag Grbic: Të nderuari zëvendësit e kryetarit, këshilltar, drejtoret e drejtorive, përfaqësuesi i OSBE-ës dhe të gjithë të tjerë të pranishëm. Mirëdita dhe mirë se vini në seancën e tetë të rregullt të K.K. Shtërpçë. Në seancën e sotme janë të pranishëm të gjithë 15 këshilltarë, që do të thotë se kemi kuorum dhe mund të fillojmë me punë. A lajmërohet edhe dikush për fjalë. Nëse nuk lajmërohet askush, vë në votim pik e rendit të ditës.
Konstatohet se me njëzë kemi aprovua rendin e ditës

2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga seanca e kaluar e KK Shtërpce

Rifat Rustemi: Sa për procesverbal vetëm me fjalën lidhëse kur e kam marr është një gabim i vogël, këtu thuhet sa për rendin e ditës nëse ka mundësi një sqarim, plani i punës që kemi bërë për muajin korrik kemi pasur në rend të ditës shqyrtimin i rregullores për tatimin në pronë për vitin 2019 fakt për vitin 2018 dhe në shtator ka qenë përsëri në rend të ditës, kam pritur që në tetor kjo pik ndoshta ka pas problem, unë këtu kam pasur fjalën për që në bazë të planit që kemi pasur në korrik, ka qenë parashikime në muaj shtator, kur e kam kërkuar sqarim në muajin shtator pse nuk u gjind kjo pika e rendit të ditës, deri sa këtu në proces shkruan që ka qenë në rendin e ditës, vetëm këtu e kam at vërejtje, të gjitha tjera janë në rregull.

Predrag Grbic: Në seancën paraprake, ju kemi shpjeguar arsyet pse kjo pikë nuk ishte në rendin e ditës, kështu që nuk do të përsërisja tani. Ju e shihni se sot është në rendin e ditës dhe drejtori pastaj do t'ju prezantojë të gjitha detajet lidhur me këtë pikë. Në serbisht ka të gjitha në procesverbal. A lajmërohet edhe dikush për fjalë? Pasi nuk lajmërohet askush e qes në votim procesverbalin.

Konstatohet se me njëzë kemi aprovua procesverbalin

3. Shqyrtimi dhe aprovimi i Rregullores mbi tatim në pronë për vitin 2019

Danijel Vuksanovic: Deri tani ne kemi miratuar këtë pikë në shtator, por këtë vit kemi bërë një përjashtim për shkak se është miratuar ligji për tatimin në pronën e paluajtshme dhe ai ka filluar të zbatohet nga 1 tetor i këtij viti. Ligji është i ndryshëm nga ai mëparshëm dhe për këtë arsye ne u detyruam që këtë pikë e qesim tani në rendin e ditës. Kemi marr një raport nga ministria më 14 të këtij muaji, kemi pasur kohë vetëm sa të përgatitemi për këtë seancë dhe ne jemi të detyruar të miratojmë këtë Rregullore në këtë muaj. Tatimi në pronë filloi të paguhet në vitin 2002 dhe tre vjet më parë, ministria ka filluar me një projekt tjetër të lidhur me tatimin për tokë dhe realizimi i këtij projekti do të fillojë nga viti i ardhshëm. Sa e përket vlerësimit të tokës, ajo është kompetenca e Ministrisë së Financave, ata ato e kanë bërë në bashkëpunim me Agjencinë Kadastrale të Kosovës, ku në çdo komunë është bërë analiza e tokës, vlerësimi dhe kategorizimi. Sot ne këtu në shqyrtim kemi përcaktimin të shkallës, në faqen e fundit, mund të shihni Nenin 3. Ne, nga pushteti ekzekutiv kemi dhënë një propozim për shkallën më të ulët, duke pasur parasysh vlerën e lartë të tokës dhe gjendjes ekonomike të popullsisë që jetojnë në komunën e Shtërpçës, shkalla është 0, 15%. Do t'i kisha lutur këshilltarët që të votojnë këtë propozim. Zonat të tokës janë bërë në bazë të kontratave të shitblerjes, vlerës të tokës Në Shtërpçë ka më shumë se 8 zona, dhe nuk është e njëjta në qendër të Shtërpçës, dhe në periferi të Shtërpçës, ashtu që edhe shkalla do të jetë e ndryshme në mes tyre. Njerëzit të cilët janë të punuar në bujqësi dhe që punojnë në përputhje me ligjin e Ministrisë së Bujqësisë do të lirohen nga tatimi. Në vitin e parë do të paguhet tatimi prej 20%, nga vlera, deri në vitin 2023, qytetarët do të jenë të detyruar të paguajnë tatimin prej 100%. Ka interes, dënim, ekzistojnë këto mekanizma nëse taksapaguesit nuk i përmbushin obligimet e tyre. Të hyrat nga këto taksa do të jenë hyrat vetanake dhe do të jenë në kategorinë e projekteve kapitale. Ky vendim është marrë nga Ministria e Financave, jo nga Komuna e Shtërpçës, do të aplikohet në tërë Kosovën.

Predrag Grbic: Ne kemi pasur disa vërejtje, për tokën e cila nuk po punohet ose për token e cila nuk ka rrugë për të ardhur deri ajo, edhe qytetarët kanë dhënë vërejtjet e tyre. Nga ministria nuk kanë marr parasysh, dhe përfundimisht kanë dhënë një vlerësim të tokës.

Rifat Rustemi: Kam një pyetje për drejtorin, unë kam pa këtë vlerësim të ministrisë së Financave edhe nuk kam mundur të kuptoj bash krejt çka nënkupton veça veç, sa për kategorizimin e zonave këtu në shumicën e rasteve po thuhet as një e treta parcela në komunën e Shtërpçës nuk ka dëshmi ose një argument ku është bazuar, në shumicën e rasteve thuhet në bazë të intervistës, kemi kontratën shitblerjes nuk kemi muajt kështu nuk kemi muaj ashtu. është mirë se shkalla është më e ulët, sepse komuna jonë është komuna e varfër. Mirë por tani po supozoj Bitia e Epërme edhe Bitia e poshtme kanë një dallim shumë të madh, gjeografikisht janë ndryshe, nuk mundem më kanë në një kategori, edhe Brodi nuk është si për rreth rrugës kryesore ata që kanë prona, si ata që ka pran pyllit, nuk mundem më hyr më një kategori. Edhe nëse ka

mundësi një sqarim konkretisht për Brod dhe Firajë. Ku është bazuar komuna kur e ka përcaktuar zonat.

Danijel Vuksanovic: Do të përsëris, atë që kam thënë më parë. Kategorizimi nuk ka bërë komuna, por Ministria e Financave. Ministria ka angazhuar njerëz profesionistë e kësaj fushës dhe ata e kanë vlerësuar tokën dhe kanë përcaktuar se cilat kategori të tokës ekzistojnë. Komuna ka pasur të drejtë vetëm për të përcaktuar zonat për tatimin në pronë, dhe ato janë të njëjta si në vitet paraprake, dhe ka 5 zona.

Rifat Rustemi: Në këtë raport i ministrisë thuhet në bazë intervistes, ata kanë mundur të intervistua një çoban, nuk ka emrat edhe mbiemrat, a është profesionist në at drejtim a çka është, vetëm thuhet në bazë të intervistës edhe nuk ka detajet më shumë, ndoshta u kanë mirë me organizua një takim edhe më ardhur përfaqësuesit e ministrisë këtu edhe me zhvillu një debat, për me pasur ne si përfaqësuesit më qartë këtë punë. Po nisna prej vetit jam i bindur që shumica koleget nuk janë vetëdijshëm çka janë tu votuar sot, nuk është e qarët. Materiali nuk është i qartë, sai përket komunës, mirë janë që janë bërë 5 zona. Duhet më u bërë kategorizimi në baze vlerës së pronës. Për shembull një lokal të ura i haxhisë prej 30 m² qira për shembull shkon 70-100€ a në Brod rreth murit ku janë do shtëpia edhe fol me dhen nuk e merr askush. Kategorizimi nuk është mirë që të bëhet blanko. Unë di që deri tani kështu ka qenë, mirë por, duhet të shikohet në të ardhmen me bërë një ndryshim.

Danijel Vuksanovic: Para 2 vite është organizuar një debat për tatim në tok, ku janë ardhur qytetarët, komunitetet shqiptare dhe serbe, dhe kemi diskutuar për këto zona dhe për vlerat për një metër katror. Kryesuesi edhe unë nuk jemi pajtuar për këto vlera. Ne kemi dërguar shkresë se vlera e tokës në territorin e komunës së Shtërpçës është e madhe, megjithatë, ata nuk e kanë marr parasysh këtë. Të gjithë që ka pasur nevojë të bëjmë na kemi bërë.

Ivica Tanasijevic: Kam një pyetje në lidhje me llogaritje e taksës, sepse në fillim nuk kam pasur e qartë kur kam shikuar sipas metrit katror dhe sipas zonës, si llogaritet kjo formulë dhe sa kushton për një familje mesatare? Mendoj se kjo është e rëndësishme për qytetarët, për të shpjeguar se si llogaritet kjo formulë.

Danijel Vuksanovic: Llogaritet metra katror, për shembull, nëse livadhi ka 1 ar, here 100, ashtu e marrim vlerën e asaj toke, dhe nëse livadhi ka vlerë për shembull 1000€, ajo pastaj behet here shkalla cila është 0.15% dhe pastaj pjesëtohet me 100, dhe ky është tatimi që do të paguhej për livadh.

Predrag Grbic: Pasi nuk lajmërohet askush për fjalë, vë në votim pik e rendit të ditës.

Konstatohet se këtë rregulloren e kemi aprovuar me 13 vota për, dy abstenime

4. Formimi i komisionit për hartimin e Planit të punës së Kuvendit

Predrag Grbic: Ju e dini që kemi mbajtur të gjitha seancat sipas Planit, ka pasur disa plotësime dhe ndryshime. Është e rëndësishme për ne, sepse e dimë se cili pika do të gjendet në të cilin muaj në rendin e ditës dhe ju si këshilltarë kanë më shumë kohë për t'u përgatitur për pikat të

caktuara. Mund të lexoj se kush ishin anëtarë të mëparshëm të komisionit, ata janë t: Miroslav Djordjevic, Srdjan Kostic, Rifat Rustemi, Garip Sahiti, unë si kryesuesi Staja Markovic si sekretar i e Kuvendit dhe drejtorët e të gjitha drejtorive. Pasi anëtarët e këtij komisioni kanë fituar tashmë një përvojë, unë sugjeroj që të njëjtët anëtarë përsëri të jenë pjesë e këtij komisioni.

Grip Sahiti: Para takimit kemi diskutuar me Rifatin për këtë çështje, për neve është krejt mirë.

Predrag Grbic: Pasi nuk lajmërohet askush për fjalë ,vë në votim pik e rendit të ditës

Konstatohet se me njëzë kemi aprovua këtë pik e rendit të ditës

5. Shqyrtimi dhe aprovimi i draft të Rregullores për organizimin e punës në arsim parauniversitar në komunën e Shtërpçës.

Sadik Imeri:Ashtu edhe si edhe emërohet kjo rregullorja, ,, Rregullorja për organizimin e punës në arsim parauniversitar të komunës së Shtërpçës” nuk ka dallime të mëdha prej asaj si veprojnë edhe punojnë në shkollat, si qe keni pa në material e bashkangjitur kjo rregullorja rregullon nga qeverisja e shkollës, drejtorët, organet udhëheqës, këshilli profesional dhe deri marrëdhënies së punës mesimdhënësve në institucionet edukatore arsimore, rregullorja është hartuar në bazë të ligjeve edhe udhëzimeve të ministrisë së arsimit në bazë të ligjit për komunat e Republikës së Kosovës, dhe hartuesit së kësaj rregullore ishin përfaqësuesit e shkollave, drejtorët e shkollave këshilli mesimdhënësve edhe nxënëseve edhe prindërve ishin edhe nga komunitete palat me interes, gjithë materialin që keni pasur në shqyrtim na nuk kemi çka me thonë veçanet, jemi të gatshëm që të pranojmë këshilla ose njanje sugjerim nga të pranishëm dhe do të përgjigjemi në pyetjet e juaj.

Garip Sahiti: Së pari e përgëzoj drejtorin për një punë të mirë që ka bërë, pasi unë punoj në arsim më vite edhe ka qenë një mugës një rregullore së tillë, kam lexuar të gjitha pika dhe mendoj që është hartuar në mënyrën shumë e mirë edhe duke bazuar në ligjin e Arsimit. Kish qenë mirë që kjo rregullorja zbatohet plotësisht dhe mos këtë diskriminime në komunitete të cilat jetojnë në komunën tonë, kur e dimë që komuniteti shqiptar e f. Biti kanë pasur shumë probleme lidhur me transportin, ku kjo rregullorja e cek të gjitha çështje e arsimit parauniversitar në komunën e Shtërpçës. Uroj që pas miratimit të kësaj rregullore nuk do të këtë probleme as në transport as probleme tjera, në të cilat hasim në pjesët të ndryshme e komunës.

Rifat Rustemi: Sa për këtë rregullore, besoj që është në rregull e kam lexuar plotësisht edhe unë e përgëzoj ata që kanë përpiluar këtë rregullore kam dëgjuar që dje ka marr ministri një vendim sa e përket masave në shkolla, kërkoj që të zbatohet në të gjitha shkolla në komunën e Shtërpçës

mos është selektive, edhe sa për këtë celulareve duhet më pas inspektime më shpeshta kush do qoftë sa prej drejtores sa prej inspektorëve e DKA-ës së komunës, ka raste kur fëmija hyn neper rrjete sociale llive, kjo është shumë shqetësuese unë di që vazhdimisht e mbikëqyrin si drejtor shkollës ashtu edhe DKA-ja, por duhet me pas pak masat e shtuara në këtë drejti sepse është paraqitur shumë në kohën e fundit .

Predrag Grbic: Kemi dëgjuar disa lëvdata dhe disa sugjerime, shpresoj se do të merret parasysh atë që ka thonë z. Rifat. Pasi nuk lajmërohet askush për fjalë,vë në votim

Konstatohet se me njëzë kemi aprovua këtë Rregullorën

6. Të ndryshme.

Rifat Rustemi: Kam një tre-katër çështje, prej atyre kam marr sot informacion që dy janë në proces. Para është çështja e emërimit i rrugëve, që e kam ngrit edhe më herët edhe di që ka pasur pak probleme, mirë është që të ulemi dhe bisedojmë, sepse nuk është problem që nuk zgjidhet nëse ka vullnet çdo problem zgjidhet, nuk është asnjë send pamundshëm kur ekziston vullneti kjo është çështje etike, që do të zgjidhet. Dyta është mungesa emërimit e zyrave në objekt e komunës edhe për këtë kam dëgjuar që është në proces, më vjen mirë. Treta është neglizhenca ndaj vendimeve e gjykatës të cilën e kam potencuar edhe më herët, unë e di që ka një here ndoshta edhe nuk ka mundësi që të paguhet sepse komuna nuk ka mjete, por nuk është mirë nëse vjen një dënim nuk paguhet më kohë, është mirë që paguhet në kohë mos më ardhur puna më ardhur deri të përmbauesi sepse nëse duhet më u paguar një gjobë 100€, edhe nuk paguhet në kohë, ajo shkon deri 500€, nuk është mirë hiq me ardhur deri të dënimi, por nëse ka vendimi i gjykatës është mirë që eliminohet aj dënim, e jo që të ngarkohet komuna edhe dihet cilin buxhet e ka komuna e Shtëpcës, kjo është si këshill.

Dimitrije Racicevic: Ka dashur që në këtë Kuvend të gjendet pika e emërimit të rrugëve në vendbanimet në komunën tonë, megjithatë, për arsye teknike nuk kemi mund të përgatitmi për këtë Kuvend, pasi sipas ligjit, propozimi duhet se parë të dërgohet në Ministrinë Planifikimit Hapësinor, që ata e shikojnë dhe të japin një vendim përfundimtar, nëse mund të shkon në Kuvend për të miratuar. Z.Rifati,e ka mirë ne jemi vonuar pak, do të jap një shembull konkret, e cila është arsyeja pse, neve vonë na kanë lajmëruar që emrat në lagjet nuk mundën të janë të njëjta, pasi është një numër i madh i rrugëve, kishim nevojë për të gjetur emrat të përshtatshëm, dhe të bisedojmë me përfaqësuesit e të gjithë vendbanimeve, për të dhënë propozime. Në dhjetor do të kemi këtë propozim dhe atëherë do të diskutojmë

Rifat Rustemi: Nuk jam informuar bash saksish, ku ka ngelur problemi, po supozoj që ndoshta është problemi qe kanë njanjë pamje nacionaliste, ndoshta dikush ka propozuar, ne mundemi me rregulluar at punë me eliminua ato edhe me ja dhen emrin për shembull rruga e Brodit , rruga e Firajesë, një emër që nuk ka të bëj me këto gjera. Na jemi dy komunitete të cilat jetojmë këtu edhe dikush donë më ja dhen ndoshta një nacionalistit e vetë, mirë, por ky është problem që ne mundemi me zgjedh vet edhe nuk mundet më ardhur askush më na zgjidh edhe besoj siç kemi mundur të përpilojmë një status e komunës, si kemi arritur të zgjedhim simbolet e komunës , edhe kjo duhet të tejkalohet, nuk mundemi me metë peng për shkakun e një marrëveshjes ose kompromisit.

Predrag Grbic: Pajtohem me juve. Ne jemi një komunë multietnike që ka një njohje të madhe për këtë marrëdhënie që kemi ndaj njëri-tjetrit në komunën tonë, ne jemi fqinjë këtu, po respektohem dhe po zhvillohem pak më mirë se disa komuna të tjera. Meqë askush nuk lajmërohet, seanca e sotme ka përfunduar.

Procesmbajtësi
Staja Markovic



Kryesuesi i Kuvendit
Predrag Grbic
